

Në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë
Tregtare" të ndryshuar dhe Nenin 28, paragrafi 3 i Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007
"Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar,
ky dokument përbën:

STATUTI

I

SHOQËRISË

"SKEPI" SHPK

TIRANË/SHQIPËRI

Tiranë, më 10.02.2021

STATUT
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"SKEPI" SHPK

Sot, më datë 10.02.2021 (dymijë e njëzet e një), në qytetin e Tiranës duke u bazuar në vullnetin e tij të lirë, të plotë dhe të singertë në bazë të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (*i ndryshuar*) dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (*i ndryshuar*), Asambleja e Ortakëve e përbërë prej:

-**Znj. Mimoza Isaj**, e bija e Shefjet, shtetase shqiptar, lindur më 18.07.1957, në Tiranë, banuese në Rrugë "Shyqyri Berxolli", Nd 21, Hyrja 1, 1001 Tiranë, mbajtëse i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: F75718090M, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakes zotëruese të 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

-**Z. Selman Isaj**, i biri i Ali, shtetas shqiptar, lindur më 19.01.1947, në Kala, banues në Rrugë "Shyqyri Berxolli", Nd 21, Hyrja 1, 1001 Tiranë, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: E70119067A, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në cilësinë e ortakut zotërues të 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kanë hartuar dhe nënshkruar këtë statut të përshtatur me ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" *i ndryshuar*, dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (*i ndryshuar*), si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë pozitën juridike të veprimtarisë private.

NENI 1
Baza Ligjore

- 1.1 Shoqëria harton këtë Statut në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" *i ndryshuar*, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", *i ndryshuar* si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë pozitën juridike të veprimtarisë private.

NENI 2
Emërtimi i Shoqërisë

- 2.1. Shoqëria tregtare do të mbajë emrin "**SKEPI**" sh.p.k.

NENI 3
Selia e shoqërisë

- 3.1 Selia kryesore e shoqërisë është në adresën: Rrugë "Shyqyri Berxolli", Nd 21, Hyrja 1, 1001 Tiranë, Shqipëri.

3.2 Shoqëria mund të krijojë degë dhe filiale në rrethe të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj.

NENI 4
Objekti i shoqërisë

4.1 Objekti i veprimtarisë ekonomike dhe qëllimi i shoqërisë është:

1. *Agjenci imobiliare. Krijim, zhvillim, zyra ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate të veçantë Franchising, aktivitet ndërmjetësimi për pasuritë e paluajtshme.*
2. *Aktivitet ne fushën e pasurive të paluajtshme, vlerësimin e pasurive të paluajtshme, angazhimin në shitjen me shumicë dhe pakicë të çdo lloj pasurie dhe të hap dyqane, degë apo zyra po të jetë e nevojshme për arritjen e qëllimit të shoqërisë. Menaxhim dhe administrim pronash dhe objektesh. Administrimin e bashkëpronësisë në prona dhe ndërtesa. Për dhënien me qira, nën qira të ambienteve të ndryshme.*
3. *Aktivitet në fushën e projektimit të godinave civile, mirëmbajtje dhe restaurim të objekteve të ndryshëm.*
4. *Organizimi i eveneteve, panaireve, publikime, reklama dhe fushata reklamuese, si dhe organizim tjetër artistik dhe televiziv të çdo forme. Konsulencë financiare, ekonomike, juridike që ka lidhje me biznesin, me aktivitetet të ndryshme tregtare të personave fizik dhe juridik, përfshirë institucion financiare dhe ato shtetërore.*
5. *Ndërmjetësim në lidhje me shitje të produkteve të ndryshme.*
6. *Investime në fushën e ndërtimit dhe tregtimit brenda dhe jashtë vendit të pasurive të paluajtshme.*
7. *Transportim mallrash, shërbime të ndryshme të lidhura me këtë aktivitet.*
8. *Aktivitet në fushën e ndërtimit me fondet e veta ose publike të objekteve të ndryshme industriale dhe civile të çdo lloji, për vete apo për të tretë, private dhe/ose publike, si dhe restaurimi apo riparimi i tyre, marrja e të drejtave dhe çdo lloj avantazhi në çdo lloj forme ligjore që është e domosdoshme për realizimin e qëllimeve të shoqërisë, si dhe shfrytëzimi i të gjitha sipërmarrjeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë e mësipërme, në kufijtë e lejuar nga ligji;*
9. *Shoqëria mund të ushtrojë veprimitari në fushën e turizmit, duke investuar me fondet e veta ose jo në këtë fushë për krijimin e qendrave, pikave dhe fshatrave turistikë, si dhe të mundësojë infrastrukturën e tyre brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;*

10. Zhvillim zonash me qëllime rezidenciale dhe tregtare, shitje-blerje e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Ushtrimi i çdo lloj operacioni dhe transaksiioni në lidhje me importimin, eksportimin, prodhimin, tregtimin, shitjen, shpërndarjen e pajisjeve dhe materialeve të ndryshme elektrike, elektro-mekanike, materiale ndërtimi, plastike apo materiale të tjera në fushën e ndërtimit dhe shërbimeve elektro-mekanike, si me shumicë dhe pakicë, në formën e lëndës së parë, gjysmë të gatshme, makineri dhe pajisje, teknologji, etj.;

11. Kryerjen e çdo aktiviteti tjetër të nevojshëm në funksion të veprimtarisë së saj.

- 4.2 Objekti i veprimtarisë së shoqërisë mund të ndryshojë ose të shtohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

**NENI 5
Kohëzgjatja e shoqërisë**

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë në rastet e prishjes, falimentimit ose të likuidimit të shoqërisë si dhe me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë, forma këto të parashikuara në legjislacionin tregtar në fuqi.

**NENI 6
Kapitali themeltar**

- 6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 2 (dy) kuota, që përfaqësojnë 100 % (njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë, i cili ka vlerën totale 100.000 (njëqind mijë) Lekë, tërësisht i nënshkruar dhe i shlyer nga Ortakët e shoqërisë.
- 6.2 Vlera e kuotave për ortakët e shoqërisë përcaktohet në bazë të kontributeve financiare të derdhura nga ata për zhvillimin dhe zbatimin e projekteve që do të realizohen për zhvillimin e aktivitetit të shoqërisë.
- 6.3 Kontributi në kapitalin themeltar zotërohet në masën e mëposhtme nga Ortakët e shoqërisë:

-Znj. Mimoza Isaj zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 50.000 (pesëdhjetëmijë) Lekë, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

-Z. Selman Isaj zotëron 1 (një) kuotë me vlerë të barabartë me 50.000 (pesëdhjetëmijë) Lekë, e cila përfaqëson 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë.

**NENI 7
Kuotat e Kapitalit**

7.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt notarial, nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve të shoqërisë.

7.3 Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, por vetëm pas ushtrimit të së drejtës së parablerjes së ortakëve ekzistues dhe këta të kenë hequr dorë shprehimisht nga kjo e drejtë.

NENI 8 **Asambleja e Përgjithshme**

8.1 Organi vendimmarrës i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Të drejtat dhe detyrat e Asamblesë së Përgjithshme në rastin se shoqëria do të ketë një Ortak të Vetëm, ushtrohen nga Ortaku i Vetëm.

8.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve ka këto të drejta dhe detyrime:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

8.3 Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme registrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet që kanë të bëjnë me riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

- 8.4 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve sipas parashikimit të pikës 8.3, janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.
- 8.5 Një ortak mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një person i tretë. Autorizimi është i vlefshëm vetëm për 1 (një) mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.
- 8.6 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakut në Asamblenë e Përgjithshme.

NENI 9 Kuorumi

- 9.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas pikës 1 të nenit 87 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar.
- 9.2 Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të nenit 86 ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.
- 9.3 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

NENI 10 Marrja e vendimeve

- 10.1 Asambleja e Përgjithshme vendlodhet me 3/4 (tri të katërtat) e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 10.2 Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit 9901 "Për Tregtarët dhe

Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar, datë 14.04.2008, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

- 10.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

NENI 11
Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

- 11.1 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.2 Prosesverbalit duhet të përbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.
- 11.3 Prosesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.4 Prosesverbalit i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

NENI 12
Administrimi

- 12.1 Administrimi i shoqërisë do të kryhet nga një administrator i vetëm.
- 12.2 Administratori është përfaqësuesi ligor i shoqërisë ndaj të tretëve. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rethanat.
- 12.3 Shoqëria tregtare "SKEPI" sh.p.k administrohet nga një person fizik.

Administrator i Shoqërisë Tregtare "SKEPI" sh.p.k është **Z. Elton Isaj**, shtetas shqiptar, i biri i Selman dhe Mimoza, lindur më 05.05.1980 në Kala, Elbasan, mbajtës i Kartës së Identitetit me Nr. Personal: I00505065P madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili do të përfaqësojë shoqërinë në të gjithë veprimtarinë e saj.

- 12.4 Administratori emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë ripërtëritje.
- 12.5 Administratori kryen të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë. Të gjitha vendimet që ai merr duhet të jenë në pajtim me interesin e sipërmarrjes.
- 12.6 Administratori ka këto kompetencia:

- Kryen të gjitha veprimet e administrimit normal të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- Përfaqëson shoqérinë tregtare në marrëdhene me të tretët personalisht ose nëpërmjet një përfaqësuesi;
- Nënshkruan për llogari të shoqërisë kontrata bashkëpunimi apo në funksion të përbushjes së objektit të veprimtarisë së Shoqërisë me të tretë;
- Nënshkruan, pas marrjes së miratimit me anë të vendimit të asamblesë së ortakëve apo ortakut të vetëm, sipas rastit, Kontratat e shitjes apo blerjes së pasurive të paluajtshme.
- Nënshkruan, pas marrjes së miratimit me anë të vendimit të asamblesë së ortakëve apo ortakut të vetëm, sipas rastit, Kontratat e Kredisë, Hipotekës, Dorëzansë apo çdo marrëdhënie të mundshme huaje e kredie me institucionet financiare, bankat e nivelit të dytë, Shoqëri dhe/apo shtetas etj.
- Administratori, ka të drejtë të hapë llogari bankare në secilën prej bankave të nivelit të dytë që operojnë në Republikën e Shqipërisë apo edhe jashtë saj, në funksion të veprimtarisë tregtare që do ushtrojë, duke pasur të drejtë të kryejë veprime bankare në cash apo on line pa limit, përfshirë këtu çdo pagesë që ka të bëjë me pagimin e pagave të punonjësve të Shoqërisë, kësteve të kredive të mundshme kundrejt bankave, taksave dhe tatimeve në nivel lokal e qëndror apo detyrime të mundshme permanente kundrejt organeve shtetërore.
- Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- Përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve i paraqet këto dokumente para Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- Krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Siguron zbatimin e vendimeve që jep Asambleja e Përgjithshme ;
- Propozon krijimin e organeve të reja për përmirësimin e punës;
- Lidh kontratat individuale dhe ato kolektive të punës;
- Të delegojë kompetencat e tij personave të tjere;
- Kryen çdo detyrë tjeter të përcaktuar në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" të ndryshuar dhe në statut.

NENI 13 **Viti finanziar**

- 13.1 Viti finanziar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.
- 13.2 Si përjashtim, viti i parë i veprimtarisë do të fillojë në datën e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe do të mbarojë më 31 Dhjetor 2021.

- 13.3 Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi veprimtaritë e vitit finansiar do të miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.
- 13.4 Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin finansiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit finansiar.

NENI 14
BILANCI. MBAJTJA E KONTABILITETIT

- 14.1 Bilanci vjetor i shoqërisë duhet të hartohet për t'iu paraqitur organeve tatimore deri në fund të muajit Mars të vitit pasardhës.
- 14.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhën shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë, të cilat do të konvertohen çdo muaj në monedhën shqiptare.
- 14.3 Pas shlyerjes së detyrimeve fiskale ndaj shtetit, fitimi neto mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit, përritjen e kapitalit të shoqërisë ose i shpërndahet ortakut sipas kuotës që ai zotëron.

NENI 15
Fitimi

- 15.1 Ortakët kanë të drejtë të mbajnë, sipas pjesmarrjes në kapital, pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, në fund të vitit ushtrimor, vetëm nëse:
 - Aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

NENI 16
Prishja dhe Likuidimi i Shoqërisë

- 16.1 Shoqëria prishet me mbarimin e afatit të përcaktuar në Statut ose para përfundimit në rastet e parashikuara me ligj, ose me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.
- 16.2 Prishja e shoqërisë ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 16.3 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raporte përfundimtare mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 16.4 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja vendos mbi bilancin finansiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesit dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.

- 16.5 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit Ortakut të shoqërisë, në proporcione kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre.
- 16.6 Likuidatori/ët njoftojnë Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e procesit të likuidimit duke kérkuar çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me parashikimet e ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", *i ndryshuar*.

NENI 17
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHEVE

- 17.1 Të gjitha mosmarrëveshet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 17.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje të mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, ato do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 18
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

- 18.1 Ky statut është hartuar në përputhje me:
 - i) Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (*i ndryshuar*);
 - ii) Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (*i ndryshuar*);
- 18.2 Për çështje që nuk janë shprehur plotësisht në këtë Statut, shoqëria i referohet legjislacionit përkatës shqiptar në fuqi.
- 18.3 Ky statut i Shoqërisë është hartuar dhe nënshkruar në 3 kopje, në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë ligjore secila prej tyre.

ORTAKËT E SHOQËRISË

"SKEPI" SHPK

ZNJ. MIMOZA ISAJ

Mimoza Isaj
(SI)

Z. SELMAN ISAJ

Selman Isaj
(SI)